



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.06.2024

Nr: 55

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË LIBOHOVË, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E KOALICIONIT “BASHKË  
FITOJMË”, ZJ. FATBARDHA TAIP KARAVIDHA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 913 prot., datë 24.04.2024, këshilli i bashkisë Libohovë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Florica Lliko Suli, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për këshillin e bashkisë Libohovë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 06, zj. Fatbardha Taip Karavidha.

Me shkresën nr. 1184, prot., datë 02.05.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Libohovë, zj. Fatbardha Taip Karavidha, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 20.06.2024 Nr: 55  
Ora: 12:00



Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Libohovë me kandidatin nga lista shumëmemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Fatbardha Taip Karavidha.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër GJR-BF-14086\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Fatbardha Taip Karavidha rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 1325 prot., datë 20.05.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1326 prot., datë 20.05.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Fatbardha Taip Karavidha.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 5976/1 prot., datë 29.05.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Fatbardha Taip Karavidha, ku konstatohet se kandidati ka ndryshuar mbiemrin me martesë nga “BILIBASHI” në “KARAVIDHA”.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 8656/1 prot., datë 29.05.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Fatbardha Taip Karavidha, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Fatbardha Taip Karavidha, në këshillin e bashkisë Libohovë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## **V E N D O S:**

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Libohovë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Fatbardha Taip Karavidha.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**